

## Roli i parlamenteve në procesin e anëtarësimit në BE

Parlamentet zgjidhen drejtpërdrejtë nga qytetarët dhe janë përgjegjëse para tyre. Ato miratojnë ligje të cilat më pas zbatohen në mbarë vendin. Një pjesë e procesit të anëtarësimit në BE përfshin harmonizimin e ligjeve nacionale me standardet e BE-së. Kjo shpesh duket e komplikuar dhe një gjë e largët nga jeta e përditshme e qytetarëve, veçmas nëse është një proces afatgjatë. Prandaj, parlamentet nacionale dhe anëtarët e tyre kanë një rol të veçantë për ti sjellë më afër këto çështje, ide dhe vlera.

Parlamentet nacionale janë pjesëmarrëse kyçe në procesin e anëtarësimit. Ato i pasqyrojnë opinionet nacionale dhe e përfaqësojnë diversitetin e qytetarëve. Ato e mbikëqyrin të gjithë procesin dhe i shprehin interesat nacionale.

Detyrat e tyre mund të grupohen në katër fushat e aktivitetëve si në vijim.

### Përafrimi me legjislacionin e BE-së

Me anë të miratimit të ligjeve, parlamentet sigurojnë transpozimin e acquis të BE-së në sistemin juridik nacional. Bazuar në planin nacional të harmonizimit të legjislacionit që përgatitet nga qeveria, parlamentet e ekzekutojnë monitorimin e fuqishëm politik mbi përafrimin ligjor.

### Monitorimi dhe shqyrtimi i hollësishëm

Parlamenti e autorizon qeverinë për përfaqësimin e pozicioneve të vendit në procesin e anëtarësimit dhe i monitoron nga afër aktivitetet e qeverisë përgjatë tërë procesit. Ndonëse qeveria është aktori kryesor në procedurën e zgjerimit, shqyrtimi i hollësishëm parlamentar e siguron konsensusin më të gjerë të mundur politik.

### Aktivitetet për ndarjen e informacionit

Parlamenti është burim i informacionit për publikun e përgjithshëm sa i përket integritimit në BE. Përmes aktivitetëve të tij, ai është përgjegjës për forcimin e vlerave të transparencës dhe të shkëmbimit të informacionit.

### Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe ndër-parlamentar

Diplomacia parlamentare është një vlerë në procesin e zgjerimit, për forcimin e reputacionit ndërkombëtar dhe të mbështetjes për vendin. Kontaktet e rregullta me Parlamentin Evropian dhe me parlamentet e vendeve anëtare të BE-së, si dhe bashkëpunimi parlamentar rajonal, janë kyç i suksesit të procesit të integritimit.

## Praktikat e mira të parlamenteve nacionale të BE-së për intensifikimin e aktivitetëve lidhur me BE-në

Sipas praktikave të mira të parlamenteve nacionale të BE-së të fituara gjatë dy dekadave të zgjerimit, janë identifikuar një numër i faktorëve të suksesit në fushat e ndryshme të aktivitetëve.

Seanca plenare, komisionet, forumet tjera parlamentare dhe administrata parlamentare, të gjitha e kanë rolin e tyre në proces. Komisioni përgjegjës për integrimin evropian – duke qenë në qendër të koordinimit të politikave rreth BE-së në parlament – kryen detyra të shumëfishta; aktivitetet e tij legjislativ, monitoruese, diplomatike dhe informuese duhet të ushtrohen në mënyrë të balancuar.

Konsensusi i fuqishëm politik dhe bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet parlamentit dhe qeverisë është i rëndësishëm së veçantë përgjatë tërë procesit.

### Përafrimi me legjislacionin e BE-së

- Parlamenti e miraton dhe e monitoron ekzekutimin në kohë të duhur të planit kombëtar për përafrimin me legjislacionin e BE-së, që përgatitet nga qeveria. Plani për përafrimin e legjislacionit shtjellohet për një periudhë 3-5 vjeçare dhe detajohet në një plan për secilin vit.
- Qeveria i siguron Kuvendit memorandumën shpjegues gjithëpërfshirës dhe tabelën e përputhshmërisë që i bashkëngjitet çdo projektligji.
- Komisioni përgjegjës për integrimin evropian merret vetëm me projektligjet që kanë të bëjnë me BE-në.

### Monitorimi dhe shqyrtimi i hollësishëm

- Mbikëqyrja e fuqishme politike e aktivitetëve të qeverisë në lidhje me BE-në është çelës i suksesit.
- Diskutimi i rregullt i progresit të arritur në procesin e anëtarësimit dhe shqyrtimi i masave të ndërmarra nga qeveria në interes të reformave përkatëse ligjore, administrative, institucionale dhe ekonomike.
- Analizimi dhe aprovimi i raportit vjetor të qeverisë për zbatimin e kontratës me BE-në.

Ky publikim është prodhuar me ndihmën e Bashkimit Evropian.

Përmajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e partnerit implementues dhe nuk mund të konsiderohet në asnjë mënyrë që i pasqyron qëndrimet e Bashkimit Evropian.

## Komisioni për Integritime Evropiane i Kuvendit të Kosovës

Komisioni për Integritime Evropiane (KIE) është një nga katër komisionet kryesore dhe aktori kryesor në Kuvendin e Kosovës në çështjet e integritimit në BE.

Përfshirja e KIE-së është e detyrueshme në procesin legjislativ; ai merret me shqyrtimin e të gjitha projektligjeve dhe të amendamenteve të dorëzuara në Kuvend nga aspekti i përafrimit të legjislacionit me acquis të BE-së. Pas hyrjes në fuqi të MSA-së, barra e punës legjislativë është rritur në masë të konsiderueshme. Së këndejmi, aktualisht aktiviteti kryesor i komisionit ndërlidhet me përafrimin me legjislacionin e BE-së.

Në kuadër të monitorimit të ekzekutiv, KIE-së i është besuar mbikëqyrja e aktivitetëve të qeverisë në lidhje me BE-në, përfshirë këtu përafrimin e legjislacionit. Për këtë qëllim, mund të kërkojë informata dhe të dhëna specifike, si dhe të iniciojë mbajtjen e dëgjimeve personale me ministrat dhe me zyrtarët tjerë.

Në përputhje me Rregulloren e Punës, fushëveprimi i detyrave dhe i përgjegjësisë të KIE-së përfshin gjithashtu bashkëpunimin dhe koordinimin me institucionet e BE-së dhe me zyrtarët e tyre në Kosovë, bashkëpunimin dhe shkëmbimin e praktikave të mira me vendet anëtare të BE-së, pjesëmarrjen në si dhe mbikëqyrjen e Procesit të Stabilizim-Asociimit, mbikëqyrjen dhe koordinimin e Instrumentit të Ndihmës së Para-Anëtarësimit (IPA), monitorimin e donatorëve dhe të programeve të bashkëpunimit të BE-së, bashkëpunimin me Këshillin e Evropës.

Në përgjithësi, KIE i mban dy deri në katër takime në muaj dhe zakonisht janë disa pika në rendin e ditës. Takimet e KIE-së janë të hapura për publikun dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile janë pjesëmarrës të rregullt.

- Organizimi i debeteve për politikën e BE-së në mënyrë të rregullt dhe të strukturuar: dy herë në vit në nivel të seancës plenare, dhe çdo 3 muaj mesatarisht në nivel të komisioneve.
- Mbikëqyrja sistematike e shfrytëzimit të fondeve të BE-së.
- Diskutimi i kontributit nacional në raportin vjetor për vendin si dhe analiza e raportit të publikuar është praktike vitale e rregullt.
- Takimet e përbashkëta të komisioneve janë një mjet i shkëlqyeshëm për diskutimin gjithëpërfshirës të politikave apo të projektligjeve që kanë të bëjnë me BE-në.

### Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe ndër-parlamentar

- Diplomacia parlamentare është esenciale për ndërtimin e besimit ndërmjet partnerëve.
- Kontaktet e rregullta me Zyrën lokale të BE-së i kontribuojnë mirëkuptimit të ndërsjellë sa i përket situatës aktuale në integrimin evropian.
- Komisioni përgjegjës për integrimin evropian e fton ambasadorin e vendit që e mban Presidencën e radhës së BE-së, për të siguruar informata të dorës së parë sa i përket programit të Presidencës.

### Aktivitetet për ndarjen e informacionit

- Për të ruajtur interesimin pro-evropian, qëndrimet dhe opinionet shkëmbehen drejtpërdrejt dhe përfshihen në debatin politik.
- Parlamenti e ka planin e vet të komunikimit rreth BE-së, për të siguruar koherencën e aktivitetëve komunikues në këtë proces afatgjatë.
- Mjetet më efikase për këtë qëllim janë organizimi i konferencave në temat përkatëse, takimet e komisioneve që mbahen jashtë hapësirave të parlamentit, publikimi i materialeve informuese, bashkëpunimi me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare, me OSHC-të dhe me akademinë.



Projekt i financuar nga BE, i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë




# Procesi i integritimit në BE: roli i Kuvendit të Kosovës dhe i Komisionit të tij për Integritime Evropiane



PROJEKTI I BINJAKËZIMIT  
Përkrahja e mëtejme për Kuvendin e Kosovës

PROJEKTI IMPLEMENTOHET NGA  
ASAMBLEJA NACIONALE E HUNGARISË



ORSZÁGGYŰLÉS



Bashkimi Evropian është krijuar me qëllim të forcimit të paqes, të prosperitetit dhe të vlerave evropiane në kontinentin e vjetër. Në vitin 1951, gjashtë shtete themeluese i hapën rrugën një partneriteti unik ekonomik dhe politik që aktualisht përbëhet nga 28 shtete, me një perspektivë të hapur për të gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Kushtet për anëtarësim

Procedura gjithëpërfshirëse e aprovimit siguron që shtetet e ardhshme anëtare janë të gatshme t'i zbatojnë standardet dhe rregullat e BE-së. Si hap i parë, shtetet duhet t'i përbushin tri kërkesat kyçe të njohura si 'Kriteret e Kopenhagës', domethënë:

- institucionet stabile të cilat e sigurojnë demokracinë, sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut dhe respektin për si dhe mbrojtjen e pakicave;
• ekonominë funksionale të tregut dhe kapacitetin për të përballuar konkurrencën dhe forcat e tregut në BE; dhe
• aftësinë për të marrë përsipër dhe për t'i zbatuar në mënyrë efikase obligimet e anëtarësimit, përfshirë këtu veprimet në përputhje me synimet e unionit politik, ekonomik dhe monetar.

Përveç kësaj, BE-ja e rezervon të drejtën për të vendosur kur është e gatshme për zgjerim në të ardhmen.

Në rastin e Ballkanit Perëndimor, një kusht special kërkon nga vendet e rajonit që të angazhohen në bashkëpunimin rajonal dhe raporte të fqinjësisë së mirë (i referuar si stabilizimi dhe asociimi).

Procesi i anëtarësimit hap pas hapi

- Së pari, vendi bëhet kandidat potencial për anëtarësim. Kjo është faza ku gjendet Kosova aktualisht.
• Së dyti, vendi bëhet kandidat zyrtar dhe bëhet hapja zyrtare e negociatave rreth anëtarësimit.
• Në fund – nëse reformat janë kompletuar për kënaqësinë e të dy palëve – vendi kandidat mund të bëhet anëtar me të drejta të plota.

Ekzaminimi

Qëllimi kryesor i tij është identifikimi i fushave në legjislacionin, institucionet apo praktikat kombëtare që kanë nevojë për harmonizim me acquis të BE-së (ligjet dhe rregullat ekzistuese të BE-së).

Negociatat

Negociatat zhvillohen në bazë të 35 Kapitujve, ku secili prej tyre korrespondon në fusha të ndryshme të politikave. Nga vendi kandidat kërkohet ti dorëzojë pozicionet negociuese të tij ndërsa vendet anëtare të BE-së pajtohen për një pozicion të përbashkët gjatë procesit të negociatave. 'Asgjë nuk është dakorduar derisa gjithçka të jetë dakorduar' është parim kryesor i negociatave.

Traktati i aderimit

Rezultatet e negociatave inkorporohen në draftin e traktatit të aderimit. Traktati i finalizuar më pas votohet nga institucionet e BE-së, dhe i dërgohet për miratim dhe ratifikim vendit kandidat dhe të gjitha vendeve anëtare të BE-së.

Raportimi dhe monitorimi

Në gjithë procesin, Komisioni i mban të informuar Parlamentin Evropian dhe Këshillin lidhur me progresin e bërë, me anë të dokumenteve vjetore të strategjisë dhe raporteve për vendet individuale. Ai i monitoron gjithashtu zotimet e marra përsipër nga vendi përkatës.

Përkrahja financiare nga BE

Lidhur me IPA

BE-ja ka në dispozicion mjete të ndryshme që ofrohen për vendet që janë në fazën e para-anëtarësimit, me qëllim të forcimit të procesit të përgatitjeve për anëtarësimin e ardhshëm. Korniza për pranimin e fondeve dhe të mbështetjes së BE-së është siguruar nga Instrumenti për Ndihmën e Para-Anëtarësimit (IPA).

IPA fokusohet në dy prioritetet kryesore: në një anë, siguron asistencë për përbushjen e kriterëve politike dhe ekonomike lidhur me miratimin e acquis të BE-së dhe zhvillimin e kapaciteteve institucionale të gjyqësorit; në anën tjetër, siguron asistencë për vendet, për t'i përgatitur ato për shfrytëzimin e fondeve strukturale dhe të kohezionit pas anëtarësimit.

Planifikimi strategjik dhe financiar i BE-së bëhet për një periudhë shtatë vjeçare. IPA I ndërmjet viteve 2007-2013 i ka mbështetur pesë komponentë (Përkrahja gjatë tranzicionit dhe ndërtimi i institucioneve, Bashkëpunimi ndërkufitar, Zhvillimi rajonal, Zhvillimi i burimeve njerëzore, Zhvillimi rural), ndërsa IPA II ndërmjet viteve 2014-2020, i synon sektorët në vijim: Demokracia dhe qeverisja, Sundimi i ligjit dhe të drejtat themelore, Energjia, Konkurrueshmëria dhe inovacioni, Edukimi, Punësimi dhe politikat sociale, Bujqësia dhe zhvillimi rural, Bashkëpunimi rajonal dhe territorial.

Në periudhën 2007-2013 janë siguruar mbi 11 miliardë EURO për vendet përfituese, që është një nga ndihmat më të mëdha për kokë banori në botë. Në periudhën 2014-2020, një shumë shtesë prej 11.7 miliardë EURO pritet të alokohet me qëllim të forcimit të institucioneve demokratike dhe sundimit të ligjit, reformat në administratën publike, mbështetjen e reformave ekonomike, promovimin e respektimit të të drejtave të njeriut dhe të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore, mbështetjen për zhvillimin e shoqërisë civile dhe avancimin e bashkëpunimit rajonal, dhe për të kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm dhe zvogëlimin e varfërisë në rajon.

Konkurrueshmëria dhe infrastruktura

BE u ndihmon shteteve që të bëhen ekonomi konkurruese të tregut, dhe si pjesë e kësaj, i mbështetë reformat ekonomike. Përgatitja e shteteve për anëtarësim nënkupton gjithashtu që të ndihmohen ato në përmirësimin e infrastrukturës së tyre, me një kombinim të granteve të BE-së dhe kredive nga institucionet financiare ndërkombëtare.

Ndërtimi i kapaciteteve

Një aspekt i rëndësishëm i asistencës së BE-së është forcimi i 'kapaciteteve institucionale'. Kjo në esencë nënkupton sigurimin e përbushjes së kriterëve të Kopenhagës, domethënë që sektori publik e di si të punojë në praktikë në çështjet e BE-së – dhe si të punojë në mënyrë efektive dhe demokratike në përgjithësi. Këshillat rreth zbatimit të acquis të BE-së mjaft shpesh ofrohen me anë të aranzhimeve të 'binjakëzimit', në të cilat dërgohen ekspertët nga vendet anëtare të BE-së, apo me anë të punëtorive të shkurtra. Kjo broshurë është përgatitur gjithashtu në kuadër të një projekti të binjakëzimit të BE

PSA

Për ti ndihmuar vendet e Ballkanit Perëndimor në rrugën e tyre drejt anëtarësimit në BE, shfrytëzohet një kornizë e veçantë nga ana e BE-së e titulluar Procesi i Stabilizim Asociimit (PSA). Kjo nënkupton një partneritet progresiv ku synimet e përbashkëta politike dhe ekonomike përcaktohen duke u bazuar në nevojat specifike të çdo vendi.

MSA

Synimet e PSA-së përkthehen në veprime konkrete që përfshihen në marrëveshjet për zbatim të cilat janë të përshtatura në mënyrë specifike për secilin vend. Në rastin e Kosovës, Marrëveshja për Stabilizim dhe Asociim (MSA) ka qenë marrëdhënia e parë kontraktuale me BE-në, e nënshkruar në vitin 2015. Ajo përmban obligime ligjore për Kosovën.

PKZMSA

Me qëllim të zbatimit të suksesshëm të MSA-së, Programi për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) është miratuar në vitin 2016. Ai është dokumenti kryesor i politikave për procesin e aderimit, domethënë është strategji për planifikimin, realizimin dhe monitorimin e realizimit të të gjitha reformave.

PKZMSA parasheh reforma për periudhën pesëvjeçare (2016-2020). Masat janë të strukturuar sipas Kriterëve të Kopenhagës dhe rrjedhimisht janë të ndara në tri blloqe: reformat e nevojshme për përbushjen e kriterëve politike, të kriterëve ekonomike dhe të standardeve evropiane, duke e bërë përafrimin e legjislacionit të Kosovës me acquis të BE-së.

ARE për Kosovën

Agjenda për Reformën Evropiane (ARE) për Kosovën e miratuar në vitin 2016, i parasheh prioritetet afatshkurtra, të përcaktuara bashkërisht nga Qeveria e Kosovës dhe Komisioni Evropian. Ajo i identifikon sfidat kryesore të Kosovës në sektorin e sundimit të ligjit, në sektorin e konkurrueshmërisë dhe në sektorin e punësimin.

Fondet e IPA-s për Kosovën

BE e mbështetë zbatimin e reformave në kuadër të IPA II. (2014-2020). Kosova pritet ta marrë një financim prej 645.5 milionë EURO.

Të pasurit e lidhjeve të ngushta me Bashkimin Evropian mund të sjellë një numër përparësish të prekshme për Kosovën, ndërsa në disa fusha procesi i integritimit mund të shtrojë sfida të vështira për vendin.

Përfitimet

- Siguria, stabiliteti politik dhe bashkëpunimi rajonal në Ballkanin Perëndimor: nën ombrellën e BE-së, vendet e rajonit mund të gjejnë mënyra dhe metoda të reja të bashkëpunimit që do të rezultojnë në prosperitetin e të gjithë rajonit.
• Prosperiteti ekonomik, zhvillimi: qasja e garantuar e bizneseve vendore në tregun global të BE-së, hyrja e brendeve evropiane në Kosovë pa tarifa doganore me çmime më të ulëta, prodhimet vendore të cilësisë më të mirë si rezultat i rritjes së konkurrencës, mbrojtja më e mirë e konsumatorit, zhvillimi i infrastrukturës nga fondet e IPA-s, janë disa nga rezultatet më të prekshme të procesit të integritimit në BE.
• Standardet më larta të jetesës, modernizimi: edukimi më i mirë, barazia gjinore, parandalimi i diskriminimit, mundësia për udhëtim pa viza në vendet e BE-së, qasja në programet e shkëmbimit të studentëve sikur që është Erasmus, apo në skemat e hulumtimeve dhe të inovacionit sikur që është Horizon, janë të hapura për qytetarët e Kosovës.
• Shteti më i fuqishëm, efikas dhe pa korrupsion: që është në gjendje të sigurojë shërbime komplekse për qytetarët nga një administratë publike e fuqizuar dhe nga gjyqësori plotësisht i pavarur dhe efikas.

Sfidat

- Përshtatja e ekonomisë për tu ballafaquar me sfidat e tregut të përbashkët evropian dhe me konkurrueshmërinë në rritje të produkteve kosovare, bashkë me organizimin efektiv të tregut të punës.
• Shfrytëzimi efektiv i asistencës teknike dhe financiare të BE-së për reformat kritike afatgjata dhe ndryshimet e nevojshme, për ta bërë Kosovën një vend modern dhe të prosperuar.
• Forcimi i funksionimit të institucioneve të Kosovës dhe përgatitja e tyre për përbushjen e detyrave në përputhje me standardet evropiane.
• Ruajtja e qëndrimit pozitiv të shoqërisë drejt integritimit në BE me anë të një procesi afatgjatë.



KALENDARI KOHOR: Marrëdhëniet e Kosovës me BE-në

